

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

25 Shkurt ,2021

Të dashur Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,


Unë jam i lumtur të ndaj që procesi i ndërmjetësimit të palëve të treta të drejtuara nga qyteti midis Drejtorisë Arsimore të Filadelfias dhe Federatës së Mësuesve të Filadelfias në rihapjen në faza të shkollave publike të qytetit tonë është në përfundim . Detajet do të finalizohen gjatë ditëve të ardhshme dhe do të ndahen me ju të Hënën, 1 Mars 2021. Në ndërkohë, **nxënësit nga Pre/K deri në klasat e dyta të cilët vendosën të ktheheshin të Hënën, 1 Mars, do të mbeten virtual deri në njoftime të ardhshme .**

Ne e kuptojmë që pasiguria për rihapjen e sigurtë të ndërtesave tona shkollore ka qenë shqetësuese dhe e papërshtatshme për shumë familje dhe se ju do të preferonit të dini detaje sot. Ajo që mund të ndaj sot është se ka ende disa detaje të rëndësishme që janë duke u përpunuar, dhe ne duam që këto detaje të finalizohen në mënyrë që të mund të njoftojmë planin e plotë favor për studentët e mësimin hibrid PreK-2 në të njëjtën kohë.

Fokusi ynë ka qenë dhe mbetet rihapja e sigurtë e ndërtesave tona shkollore kështu që ne mund të fillojmë ngadalë të ofrojmë mundësi mësimi në - person për studentët dhe familjet tona që duan dhe kanë nevojë për këtë mundësi mësimi, duke filluar me nxënësit tanë më të rinj.

Unë pres të ndaj detajet të Hënën. Faleminderit për durimin dhe mirëkuptimin ndërsa përfundojmë procesin e ndërmjetësimit në interesin më të mirë të studentëve dhe personelit tonë.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias